

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 11.12.2015]

Për: Shoqerine “Consulting & Management Albania” Shpk me NIPT K82206013U.

Procedura e prokurimit: **“Kerkese per Propozime”** me objekt : **Mbikqyrje punimesh për ndërtimin e qëndrës sportive për sportin “Rafting”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Mbikqyrje punimesh për ndërtimin e qëndrës sportive për sportin “Rafting”.**

Fondi limit: **968.913 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë** pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 26.11.2015.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: Nr.	Shoqeria	Vlera e ofertes pa tvsh
1	ASH ENGINEERING	689,000
2	ZENIT 06	750,000
3	CONSULTING & MANAGEMENT ALBANIA	788,083

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem me arsyt perkatese:

Shoqeria “A. SH Engineering” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me stafin e propozuar pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per angazhimin ne staf te nje inxhinieri hidroteknik, ne perputhje me kerkesen.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me realizimin e sherbimeve te ngjashme. Per te provuar plotesimin e ketij kushti ka paraqitur disa kontrata mbikqyrje per rruge, kanalizime, objekte kullimi etj, por asnje prej ketyre kontratave nuk mund te konsiderohet si e ngjashme me kontraten qe prokurohet (ndertim godine). Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Shoqeria “Zenit 06” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me stafin e propozuar. Ne daten 16.07.2014 ka lidhur nje kontrate pune me arkitekten Rajmonda Daja, por zonja Daja nuk figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar Shkurt 2015 deri Gusht 2015. Gjithashtu nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per angazhimin ne staf te nje inxhinieri hidroteknik, ne perputhje me kerkesen.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me realizimin e sherbimeve te ngjashme. Per te provuar plotesimin e ketij kushti ka paraqitur dy kontrata: kontraten “Mbikqyrje punimesh ne objektin sistemim asfaltim rruga e Gjinarit” dhe “Mbikqyrje punimesh per objektin prita malore, gjelberim me bimesidhe frutore ne komunen Mollas Elbasan”. Asnje prej ketyre kontratave nuk mund te konsiderohet si e ngjashme me kontraten qe prokurohet (ndertim godine).

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**Consulting & Management Albania**” Shpk me NIPT K82206013U, se oferta e paraqitur, me një vlerë **788.083 (shtateqind e tetedhjetë e tete mije e tetedhjetë e tre)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **03.12.2015**.

Ankesa: Nuk ka patur.